

VENDIM
Nr. 528, datë 29.7.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 420, DATË 8.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E CEREMONIALIT SHTETËROR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 43/2015, “Për shërbimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të nënpikës 1.2, të pikës 1, të kapitullit V, “Vizita dhe takime”, të vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Vizitat zyrtare mund të shoqërohen dhe me zbukurim flamujsh të vendit mik dhe atij shqiptar.”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama